

VENDIM
Nr. 239, datë 30.3.2016

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 15.9.2015, PËR ÇËSHTJEN “LULI KUNDËR SHQIPËRISË” (APLIKIMI NR. 30601/08)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.9.2015, për çështjen “Luli kundër Shqipërisë” (aplikimi nr. 30601/08), në favor të z. Pëllumb Luli, në shumën 27 000 (njëzet e shtatë mijë) euro, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së, ekzekutimin e vendimit nr. 1011, datë 31.5.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve”, për kompensimin, në një nga mënyrat e parashikuara në ligj, vetëm të pjesës takuese të kërkuarit z. Pëllumb Luli.

3. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

4. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuarit, z. Pëllumb Luli, në shumën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.9.2015, për çështjen “Luli kundër Shqipërisë” (aplikimi nr. 30601/08).

5. Pagesa e shumës së depozituar në favor të z. Pëllumb Luli të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda një afati 3-mujor, nga dita kur vendimi i Gjykatës është bërë përfundimtar.

6. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të shumës së përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, për periudhën e mospagimit, plus 3 (tre) për qind.

7. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama